




---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**  
**FAKULTETI I EKONOMISË**  
**DEPARTAMENTI FINANCË-KONTABILITET**


# **UDHËZUËSI I PRAKTIKËS PROFESIONALE**

## **PROGRAMI I STUDIMIT** **BACHELOR FINANCË-KONTABILITET**



## **PËRMBAJTJA**

<b>HYRJE.....</b>	<b>3</b>
<b>Qëllimet specifike.....</b>	<b>3</b>
<b>PALËT Pjesëmarrëse në realizimin e praktikës.....</b>	<b>4</b>
<b>Përgjegjësitë e palëve pjesëmarrëse në realizimin e praktikës.....</b>	<b>4</b>
<b>Përgjegjësitë e studentit .....</b>	<b>4</b>
<b>Përgjegjësitë e subjektit pritës.....</b>	<b>5</b>
<b>Përgjegjësitë e Departamentit të Financë-Kontabilitetit.....</b>	<b>6</b>
<b>REALIZIMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE.....</b>	<b>7</b>
<b>SHTOJCAT.....</b>	<b>10</b>
<b>Shtojca A: Programi i praktikës profesionale.....</b>	<b>10</b>
<b>Shtojca B: Formular i vlerësimit të studentit praktikant nga mbikqyrësi në institucion/ kompani/ organizatë.....</b>	<b>14</b>
<b>Shtojca C: Formular vlerësimi i pedagogut udhëheqës për studentin praktikant .....</b>	<b>16</b>
<b>Shtojca D: Formular miratimi i praktikës profesionale.....</b>	<b>18</b>



## **HYRJE**

Programi i studimit Bachelor “Financë-Kontabilitet”, hartuar nga Departamenti i Financë-Kontabilitetit në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, zhvillon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në të gjitha aspektet e kontabilitetit dhe financave të institucionit/kompanisë/organizatës. Komponentët e këtij programi i’u japin mundësinë studentëve të mësojnë nga përvojat praktike nëpërmjet realizimit të praktikës profesionale në botën reale të institucionit/kompanisë/organizatës. Praktika profesionale është hartuar për t’iu dhënë studentëve formim dhe përgatitje profesionale më të plotë. Ajo ju jep njohurive të marra nga studentet në auditor një dimension të ri dhe i përgatit ata për të hyrë në tregun e punës. Praktika profesionale ndihmon studentin në zhvillimin e të kuptuarit të marrëdhënieve njerëzore dhe për të mësuar, për të punuar me të tjerët si një anëtar i një ekipi. Në të njëjtën kohë ajo është një test për studentët në botën reale të institucionit/kompanisë/organizatës. Pjesëmarrja në këtë program e bën më inteligjente vendimmarrjen e tyre të ardhshme. Si një student i diplomuar, përvoja e fituar gjatë praktikës profesionale e bën studentin më të përshtatshëm për tregun e punës dhe rrit mundësitë e kualifikimit të tij. Udhëzuesi i praktikës profesionale diskutohet dhe miratohet në departament para fillimit të vitit akademik.

## **Qëllimet specifike**

Udhëzuesi i praktikës është një **material orientues për studentët** dhe i’u jep atyre mundësinë:

- e përfshirjes reale në eksperiencën praktike të institucionit /kompanisë /organizatës, e cila normalisht nuk mund të realizohet në auditor;
- e informimit mbi industrinë apo disiplinat për të cilat kanë interes punësimi në të ardhmen;
- e krijimit të kontakteve për të ndihmuar në sigurimin e punësimit për studentët dhe institucionin/kompaninë/organizatën.

Nga ana tjetër institucionit /kompanisë/ organizatës i ofrohen shërbimet e studentëve, njohuritë e tyre si dhe një perspektivë e re për zhvillimin e tyre. Një tjetër përfitim për

institucionin/ kompaninë/ organizatën ku do të zhvillohet praktika profesionale është mundësia për të vlerësuar studentin si një punonjës potencial. Realizimi i këtij udhëzuesi ofron për Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë, mundësinë e përmirësimit të programit të studimit Bachelor “Financë – Kontabilitet” në përgjithësi dhe të përmbajtjes të disiplinave individuale në veçanti.

## **PALËT PJESËMARRËSE NË REALIZIMIN E PRAKTIKËS**

**Studenti:** i cili merr pjesë në praktikë dhe merr kredite akademike për realizimin me sukses të praktikës profesionale në Programin e studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet. Mbështetur tek plani mësimor i programit të studimit Bachelor Financë-Kontabilitet praktika profesionale do të zhvillohet në fund të semestrit të gjashtë të vitit akademik dhe vlerësohet me dy kredite. Studenti do të kryejë pesë orë praktikë në ditë për një periudhë dy javore.

**Institucioni/ kompania/ organizata:** përfaqësuesi ku do të zhvillohet praktika profesionale, i cili ofron "botën reale", mjedisin dhe përvojën e tij për studentët praktikantë.

**Departamenti i Financë-Kontabilitetit:** Komisionet e mbikqyrjes dhe vlerësimit të praktikës që veprojnë si ndërlidhës midis studentëve dhe institucionit/ kompanisë/ organizatës do të lehtësojnë punën e përgjithshme për realizimin e praktikës. Komisionet e praktikës do të jetë përgjegjës për monitorimin e aspekteve akademike e administrative të praktikës dhe përcaktimin e notës përfundimtare të studentit.

## **PËRGJEGJËSITË E PALËVE PJESËMARRËSE NË REALIZIMIN E PRAKTIKËS**

### **Përgjegjësitë e studentit**

Për një përfitim maksimal praktik dhe akademik, studentët pjesëmarrës në praktikën profesionale duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Do të kryejnë pesë orë praktikë në ditë gjatë gjithë kohëzgjatjes së praktikës profesionale. Puna e studentit do të kryhet në vendin e punës të caktuar nga përfaqësuesi i institucionit/ kompanisë/ organizatës.
- Do të marrin pjesë në mënyrë aktive në të gjitha takimet e planifikuara në auditor.
- Do të plotësojnë një raport përfundimtar me shkrim dhe do ta dorëzojnë atë ditën e fundit të realizimit të praktikës profesionale pranë komisionit të mbikqyrjes dhe vlerësimit të praktikës.
- Do të përgatitin dhe do të kryejnë një prezantim me gojë lidhur me praktikën e studentit në institucion/ kompani/organizatë, që do të mbulojë informacionin që gjenden në raportin përfundimtar me shkrim. Prezantimi do të jetë në një minimum prej dhjetë dhe një maksimum prej njëzet minuta dhe do të kryhet në auditor. Detajet specifike në lidhje me paraqitjen dhe vlerësimin e prezantimit me gojë do të jepen gjatë një prej takimeve në auditor.
- Do të jenë profesionalë në punën e tyre, në aparençë dhe në sjellje.
- Do të jenë të sjellshëm dhe të vëmendshëm në marrëdhëniet e tyre me të tjerët.

### **Përgjegjësitë e institucionit/ kompanisë/ organizatës**

Departamenti i Financë-Kontabilitetit pranë Fakultetit të Ekonomisë do të monitorojë me kujdes realizimin e praktikës profesionale nga studentët e programit Bachelor Financë-Kontabilitet me qëllim që secili prej tyre të përmbushë objektivat e vendosura dhe të reflektojë në mënyrë aktive atë që ka mësuar gjatë gjithë viteve të studimit. Për më tepër kjo praktikë në institucion/ kompani/ organizatë duhet të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në rritjen intelektuale, personale dhe profesionale të studentit. Në këtë kontekst, që praktika të kthehet në një përvojë të vlefshme mësimi, institucioni/ kompania/ organizata që marrin pjesë në të duhet të bien dakord që:

- Të identifikojnë detyra kuptimplota dhe sfiduese për studentët si dhe përgjegjësitë e studentëve në realizimin e praktikës në mënyrë që t'ju sigurojë atyre një përvojë mësimi autentike, të organizuar dhe të strukturuar mirë.
- Të bashkëpunojnë me studentët për të zhvilluar një përshkrim të punës, i cili përcakton detyrat specifike që do të kryhen dhe përgjegjësitë që do të plotësohen nga studenti gjatë praktikës.

- Të sigurojnë që studentëve do t'ju lejohej të kryejnë detyrat e përshkruara në përshkrimin e punës.
- Të caktojnë një mbikqyrës të drejtpërdrejtë i cili do të jetë përgjegjës për të monitoruar nga afër performancën e studentit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të caktuara dhe të bëjë vërejtje për punën e studentit.
- Të sigurojnë hapësirën e nevojshme dhe të vërë në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për studentët për të kryer detyrat e caktuara.
- Të investojnë kohën e nevojshme dhe përpjekje për të mësuar studentët sa më shumë të jetë e mundur në lidhje me misionin, objektivat, strukturën, procedurat operative dhe kulturën e organizatës.
- Të lejojnë studentët (kur është e përshtatshme), të marrin pjesë në takimet e punës, me qëllim ekspozimin e tyre ndaj proceseve vendim-marrëse dhe të zgjidhjes së problemeve.
- Të rishikojnë raportin dyjavor të studentit dhe, sipas mendimit të tyre, të bëjnë komente kur e shikojnë të nevojshme.
- Të sigurojnë që një përfaqësues nga organizata, preferohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i studentit, të marrë pjesë në prezantim me gojë të studentit lidhur me realizimin e praktikës.
- Të sigurojnë një vlerësim të performancës së studentit pas realizimit të praktikës profesionale. (Shtojca B).
- Të informojnë Përgjegjësen e Departamentit të Financë-Kontabilitetit, lidhur me rastet e mospërbushjes nga ana e studenteve të: (1) detyrave të caktuara; (2) standardeve të duhura dhe profesionale të sjelljes, (3) politikave të biznesit pritës.
- Të respektojnë politikat dhe procedurat e Fakultetit të Ekonomisë që kanë të bëjnë me implementimin e praktikës në programin e studimit Bachelor Financë-Kontabilitet.

### **Përgjegjësitë e Departamentit të Financë-Kontabilitetit**

Departamenti i Financë-Kontabilitetit do të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

- Udhëheqësit e praktikës profesionale do të monitorojnë të gjitha aspektet akademike të praktikës; nga mbajtja e kontakteve të shpeshta personale me studentet, organizimin, planifikimin dhe kryerjen e takimeve në auditor;

shqyrtimin e raportit dyjavor, vlerësimin e prezantimit me gojë dhe vlerësimin e raportit përfundimtar të paraqitur nga studentët.

- Pas përfundimit të Praktikës profesionale, udhëheqësit e praktikës do të plotësojnë formularin e vlerësimit të studentit praktikant (Shtojca C).
- Udhëheqësit e praktikës do të sigurojnë që studentit i është dhënë numri i duhur i kreditive akademike pas përfundimit të suksesshëm të praktikës profesionale.
- Përgjegjësjë e Departamentit të Financë - Kontabilitetit do të lehtësojë aspektet administrative të Praktikës profesionale dhe do të jetë në dispozicion të studentëve dhe të institucionit/ kompanisë/ organizatës për të zgjidhur ndonjë problem procedural që mund të lindë gjatë realizimit të praktikës.
- Udhëheqësit e praktikës do të respektojnë rregullat dhe procedurat e institucionit/ kompanisë/ organizatës dhe do të bashkëpunojnë për të zgjidhur çdo konflikt.

## **REALIZIMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE**

- Studentët duhet të dokumentojnë përfundimin e orëve të kërkuara të zhvillimit të praktikës. Formulari i miratimit të praktikës profesionale plotësohet nga studenti dhe dorëzohet pranë komisionit të praktikës pasi është firmosur nga mbikëqyrësi në vendin e praktikës dhe pasi është marrë vula e institucionit të praktikës. (Shtojca D).
- Raporti përfundimtar i shkruar është një pjesë shumë e rëndësishme e realizimit të praktikës. Përmbajtja e raportit paraqet të gjithë punën e bërë nga studenti dhe që pritet të jetë një përvojë e vlefshme për të. Në mënyrë që të siguroheni që raporti përfshin aspektet e rëndësishme të praktikës tuaj, është e rëndësishme që ju të mbani shënime lidhur me punën tuaj. Mos prisni deri në ditën e fundit dhe pastaj të përpiqeni të kujtoni çdo gjë që ka ndodhur gjatë tërë praktikës tuaj. Kur jeni duke përgatitur raportin përfundimtar, mbani në mend se raporti ka për qëllim të jetë një analizë e gjithë punës tuaj. Nuk është e mjaftueshme që thjesht të jetë një listë e aktiviteteve në të cilat keni marrë pjesë. Analiza juaj duhet të përqëndrohet në gjërat që ju keni mësuar gjatë praktikës. Ajo që do të jetë veçanërisht e dobishme për studentët, është se ajo duhet që të përfshijë ato që ata


kanë mësuar në lidhje me "botën reale". Gjithashtu raporti duhet të përfshijë njohuritë e mësuar në auditor, të cilat ju ishit në gjendje t'i aplikoni gjatë praktikës. Së fundi, raporti duhet të identifikojë, në sa më shumë detaje që të jetë e mundur, edhe njohuri dhe module (lëndë) të cilat nuk janë të mbuluara, ose nuk janë përfshirë në mënyrë adekuate në programin tuaj, por që do të kishin qenë të dobishme për ju gjatë praktikës.

- ❖ Raporti i praktikës tuaj duhet të jetë: të paktën 15 faqe (duke përfshirë bibliografinë, grafikët dhe tabelat);
  - ❖ Font style duhet të jetë Times New Roman, font size 12, dhe line spacing 1.5;
  - ❖ Afati për dorëzimin e raportit duhet të respektohet në mënyrë strikte;
  - ❖ Qëllimi i shkrimit të raportit është që të zbatoni njohuritë tuaja të fituara gjatë studimeve në parametrat praktike, prandaj projekti juaj duhet të përfundojë me rekomandime për punëdhënësin tuaj (p.sh. duke theksuar problemet kryesore, duke sugjeruar ide për përmirësim, duke inkurajuar hulumtime të mëtejshme).
  - ❖ Ju duhet të përdorni burimet e përditësuara (deri në 5 vjet). Mos u kufizoni vetëm me politikat dhe intervistat e kompanisë. Rishikoni literaturën profesionale dhe akademike në punën tuaj.
  - ❖ Raporti përfundimtar duhet të përmbajë dhe të diskutojë temat e përfshira në programin e praktikës të treguar në Shtojcën A.
  - ❖ Referencat / Bibliografia: Burimet për të dhënat dhe informacione të tjera të përdorura në raport duhet të shkruhen në këtë seksion duke cituar referenca brenda tekstit të raportit, duke përdorur stilin e referimit APA / MLA ose të Harvardit.
  - ❖ Shtojca: Bashkangjithini të gjitha dokumentet mbështetëse të përdorura në përgatitjen e raportit tuaj, si broshurat, gazetat, formularët, pyetësorët etj.
- Pas përfundimit të praktikës mbikqyrësi në vendin e punës duhet të miratojë orarin tuaj të punës dhe ta nënshkruajë atë.



## Udhëzuesi i praktikës profesionale Bachelor Financë-Kontabilitet

- Vlerësimi i punëdhënësit. Vlerësimi i mbikëqyrësit të vendit të punës për studentin në punë duhet të nënshkruhet nga ai dhe të paraqitet tek udhëheqësi i praktikës. (Shtojca B)
  
- Në fund të praktikës student do të vlerësohet me një notë (4-10) nga komisioni i vlerësimit të praktikës bazuar tek:
  - ❖ Përmbajtja dhe cilësia e raportit përfundimtar të shkruar (50%);
  - ❖ Prezantimi me gojë i punës së realizuar (30%);
  - ❖ Vlerësimi i organizatës pritëse për punën e studentit (10%).
  - ❖ Vlerësimi i studentit praktikant nga pedagogu udhëheqës (10%).



## **SHTOJCAT**

### **Shtojca A: Programi i praktikës profesionale**

Praktika profesionale do të përfshijë çështjet e trajtuara në lëndët që zhvillon program i studimit Bachelor Financë- Kontabilitet si më poshtë:

#### *Investime*

- Tipet e investimeve të realizuara nga subjektet dhe mënyra e vlerësimit të tyre.
- Burimet e financimit të investimeve
- Analiza e investimeve financiare.

#### *Analiza e pasqyrave financiare*

- Analiza e Bilancit Kontabël të firmës
- Analiza e Pasqyrës së Rezultatit (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve).
- Analiza e Pasqyrës së Flukseve së Parasë (Cash-Flow)


#### *Drejtimi financiar*

- Bazuar në të dhënat e viteve të fundit shpjegoni për firmën tuaj problemet e menaxhimit të kapitalit punues( mjetet dhe detyrimet korrente)
- Paraqisni (edhe grafikisht) dhe shpjegoni politikat e financimit dhe investimet në kapitalin punues
- Llogarisni dhe interpretoni raportet me kryesore financiare dhe ciklin e kthimit të keshit duke bërë dhe analizën ekonomike e financiare të pozicionit të firmës shoqëruar dhe me rekomandimet tuaja për problemet kryesore.

#### *Tregje dhe institucione financiare*

- Llojet e investimeve që kryejnë bankat tregtare
- Investimi i shumave të depozituara në bono thesari, (sipas maturimit të BTh, sipas shumave)
- A luajne rolin e ndërmjetësit bankat tregtare për të blerë BTh për llogari të klientëve të tyre.

#### *Teknika bankare*



- Llojet dhe shërbimet financiare të ofruara nga bankat tregëtare në Rajonin e Korcës
- Normat e interesit të përdorura nga bankat dhe ndryshimi i tyre gjatë 10 viteve të fundit
- Format e kredihënies bankare dhe problematikat që lidhen me këtë aktivitet, (kushtet, procedurat dhe kriteret që vendos banka për të dhënë kredi, dhe analiza e biznesit ose individit huamarrës nga ana e bankierit).

#### *Kontabilitet i kostos dhe i drejtimit*

- Dokumentimi i qarkullimit të materialeve në njësinë X
- Llogaritja e pagave në njësinë X dhe shpërndarja e shpenzimeve për paga në koston e produkteve
- Si përdoret nga biznesi për vendimmarje ky lloj kontabiliteti?
- Si e realizojnë procesin e zgjedhjes midis alternativave të ndryshme të investimit?
- Ndikimi i kostos në vendimmarje dhe në politikat e cmimit.

#### *Kontabilitet publik*


- Njësitë vartëse të njësive publike mbajnë kontabilitet unik apo të vecuar? Specifikat e secilës
- Si operohet me asetet e lena me qera nga njësitë publike (makineri ose linja të ndryshme)
- Si procedohet për hartimin e projekt-buxhetit për periudhën e ardhme kontabël?

#### *Drejtimit bankar*

- Si e menaxhojnë kapitalin bankat? Standardet që përdorin
- Menaxhimi i likuiditetit bankar, si realizohet, metodat
- Vendosja e çmimeve të shërbimeve bankare

#### *Bankim Qendror*

- Ku qëndron rëndësia e degës të Bankës së Shqipërisë në Korçë?
- Si futet në qarkullim paraaja me kurs ligjor në Republikën e Shqipërisë?



- Si Banka e Shqipërisë ndikon në vendosjen e normave të interesit të tregut shqiptar?
- Çfarë roli luan Banka e Shqipërisë në trajtimin e bankave në vështirësi financiare dhe nëpërmjet cilave mjete?
- Çfarë instrumenta të politikës makroprudenciale ka në dispozicion Banka e Shqipërisë dhe sa të efektshëm janë ata?

#### *Bazat e vlerësimit të pasurive të paluajtshme*

- Cilat janë hapat që ndiqen për vlerësimin e pasurive të paluajtshme
- Çfarë probleme hasen gjatë vlerësimit të pasurive të paluajtshme
- Si kryhet vlerësimi, ekzekutimi dhe menaxhimi i kolateralit nga ana e bankave pasi kolaterali është i poseduar nga banka
- Cilët janë komponentët e taksës së pasurisë dhe si kryhet administrimi i saj

#### *Kontabilitet financiar*

- Cilat janë librat që mbahen nga biznesi për regjistrimet kontabël? Diskutoni rreth formës së ditarit të përgjithshëm, ditarëve ndihmës ose analitikë, librit të llogarive, dhe librave të tjerë analitikë.
- Cilët janë elementët përbërës të dokumenteve kontabël që justifikojnë transaksionet, të tilla si: faturat, fletë - daljet, fletë - hyrjet, listë - pagesat, mandat arkëtimet? Diskutoni rreth llojeve të informacioneve që ato duhet të përmbajnë.
- Cilën metodë përdor biznesi për llogaritjen dhe regjistrimin e shpenzimeve të amortizimit? A përdoret e njëjta metodë si për qëllime tatimore ashtu dhe për raportimin financiar? Diskutoni rreth efekteve të ndryshme që kanë në pagesën e tatimeve përdorimet e metodave të ndryshme për qëllime tatimore dhe për qëllime të raportimit financiar.
- Cila metodë përdoret për matjen e kostos së inventarit të shitur? Diskutoni rreth efekteve të mundshme në rast përdorimi të një metode alternative (p.sh metoda LIFO).
- Cilët janë përbërësit kryesorë apo elementët tipikë që përmban pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të biznesit ku jeni vendosur? Diskutoni shkurtimisht për secilin prej tyre.

- Cilët janë përbërësit kryesorë apo elementët tipikë që përmban pasqyra e bilancit kontabël të biznesit ku jeni vendosur? Diskutoni shkurtimisht për secilin prej tyre.

*Sistemi doganor*

- Funksionimi i doganave
- Problematikat në menaxhimin e të ardhurave doganore, shpenzimeve
- Roli kyç i doganave në mbrojtjen e konsumatorit
- Bashkëpunimi doganor
- Lufta kundër kontrabandës



Universiteti "Fan S. Noli"  
FAKULTETI I EKONOMISË

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË  
FAKULTETI I EKONOMISË  
DEPARTAMENTI FINANCË-KONTABILITET

**Formulari i Vlerësimit të Studentit Praktikant<sup>1</sup>**  
**Bachelor në Financë-Kontabilitet**

Emri i Studentit: \_\_\_\_\_ Programi i Studimit \_\_\_\_\_

Institucioni/Kompania/Organizata \_\_\_\_\_ Pozicioni pranë institucionit/kompanisë/organizatës \_\_\_\_\_

Emri i Mbikëqyrësit \_\_\_\_\_ Pozicioni i mbikëqyrësit në institucion/kompani/organizatë \_\_\_\_\_

<b>Vlerësimi i studentit<sup>2</sup>:</b>	1 Shumë Dobët	2 Dobët	3	4	5	6	7	8	9 Shumë Mirë	10 Shkëlqyeshëm
1. Aftësinë dhe interesin për të mësuar.										
2. Aftësi Komunikuese me stafin.										
3. Iniciativë dhe krijimtari.										
4. Aftësia vendimmarrëse/ Aftësi në zgjidhjen e problemeve.										
5. Aftësitë analizuese.										

<sup>1</sup> Ky formular plotësohet pas përfundimit të praktikës nga **MBIKËQYRËSI** në **Institucion/kompani/organizatë** ku është zhvilluar praktika. Formulari i dorëzohet i mbyllur në zarf Pedagogut mbikëqyrës.

<sup>2</sup> Sistemi i vlerësimit nga 1-10, ku 1= shumë dobët dhe 10= shkëlqyeshëm.

6. Të qenit i hapur ndaj kritikave.										
7. Respektimi i etikës dhe rregullave të institucionit.										
8. Aftësi për të punuar në grup/mënyrë të pavarur.										
9. Aftësi organizative edhe për ndjekjen e punës së dhënë deri në përfundimin e saj.										
10. Korrektesë në respektimin e orarit të punës.										
<b>Nën-Totali</b>										
<b>Totali</b>										

**Listoni aftësi/ njohuri të tjera të studentit praktikant të fituara gjatë praktikës profesionale.**

Emri Mbiemri Mbikëqyrësit (në institucion/kompani/organizatë)

Data, vendi:

(Firma)

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



Universiteti "Fan S. Noli"  
FAKULTETI I EKONOMISË

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË  
FAKULTETI I EKONOMISË  
DEPARTAMENTI FINANCË-KONTABILITET

## Formular vlerësimi i pedagogut udhëheqës për Studentin Praktikant<sup>1</sup> Bachelor në Financë-Kontabilitet

Emri i Studentit: \_\_\_\_\_ Programi i Studimit \_\_\_\_\_  
Institucioni/Kompania/Organizata \_\_\_\_\_ Pozicioni pranë institucionit/kompanisë/organizatës \_\_\_\_\_  
Emri i Pedagogut Udhëheqës \_\_\_\_\_

Fusha e vlerësimit	PO	Jo gjithmonë	JO
1. Përkon pozicioni i studentit në vendin e praktikës me programin e ndjekur të studimit?			
2. Ka raportuar studentit në mënyrë periodike mbi mbarëvajtjen e praktikës mësimore?			
3. Ka mbajtur mbikëqyrësi komunikime të vazhdueshme mbi mbarëvajtjen e praktikës së studentit?			
4. Është hartuar raporti i praktikës mësimore konform rregullave dhe udhëzimeve?			

Keni komente të tjera mbi mbarëvajtjen e praktikës profesionale të studentit?

Mbi bazën e raportimeve periodike të studentit dhe mbikëqyrësit, si dhe mbi bazën e raportit të praktikës profesionale, si do e vlerësonit performancën e studentit praktikant?

<sup>1</sup> Ky formular plotësohet pas përfundimit të praktikës nga PEDAGOGU UDHËHEQËS. Formulari dorëzohet i mbyllur në zarf komisionit të vlerësimit të praktikave mësimore.



- Studenti e përfundoi me sukses periudhën e praktikës profesionale.
- Studenti e përfundoi periudhën e praktikës profesionale, por kam rezerva për mbarëvajtjen e saj.
- Studenti nuk ka respektuar rregullat e zhvillimit të praktikës mësimore.

**Emri Mbiemri i pedagogut udhëheqës**  
**(Firma)**

**Data, vendi:**

\_\_\_\_\_



Universiteti "Fan S. Noli"  
FAKULTETI I EKONOMISË

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË  
FAKULTETI I EKONOMISË  
DEPARTAMENTI FINANCË-KONTABILITET

1

## Formular miratimi i Praktikës Profesionale Bachelor në Financë-Kontabilitet

<b>Emër Mbiemër i Studentit</b>	
<b>Të dhënat e studentit</b>	
Adresa	
Qyteti	
Telefoni	
Adresa e Emailit	
Programi i studimeve	
<b>Të dhënat e praktikës:</b>	
Emri i kompanisë/Institucionit/Organizatës	
Adresa	
Qyteti	
Telefoni:	
Adresa e emailit/website	
Data e fillimit e praktikës profesionale:	
Data e mbarimit e praktikës profesionale:	
Orët javore të punës	
Kushte të veçanta të punës:	
<b>Mbikëqyrësi përgjegjës për monitorimin e punës së Studentit</b>	
Emri, Mbiemri	
Pozicioni i Mbikëqyrësit në kompani	
Telefoni	
Adresa e Emailit	
<b>Roli i Studentit Praktikant</b>	
Pozicioni punës	
Departamenti	
Detyrimet e pozicionit	
Objektivat e praktikës	

Mbikëqyrësi në vendin e praktikës

Studenti \_\_\_\_\_

(Emër Mbiemër)

(Firma, vula)